

Sektor i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vepruar mbi konkluzionin e sektorëve të katër Gjykatave të Apelit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për shqyrtimin e çështjes juridike se kush është i legjitimuar aktiv për të parashtruar padi për borxhin e regresit nga një automjet i pasiguruar, në seancën e mbajtur më 30.05.2022, në përputhje me nenin 33 nga Rregullorja e punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi këtë:

## **MENDIM JURIDIK**

**Të drejtë për regres në lartësi të dëmit të paguar të shkaktuar nga një automjet motorik i pasiguruar ka vetëm Byroja nacionale për sigurim.**

### **A r s y e t i m**

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut – Sektor i veprave civile, është dorëzuar konkluzion nga takimi i punës të sektorëve civil të Gjykatës së Apelit Gostivar, Gjykatës së Apelit Manastir, Gjykatës së Apelit Shkup dhe Gjykatës së Apelit Shtip, të mbajtur më 06.10.2021, që Gjykata Supreme të prononcohet për çështjen juridike se kush është i legjitimuar aktiv për të parashtruar padi për borxhin e regresit nga një automjet i pasiguruar, vallë Byroja nacionale për sigurim ose Shoqëria e sigurimit që ia ka kompensuar dëmin personit të dëmtuar, kurse duke ofruar sigurimin në zbatimin e ligjit dhe unifikimin e praktikës gjyqësore.

Sektor i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke shqyrtuar për çështjen juridike të parashtruar miratoi mendim juridik për këto arsye:

Në përputhje me nenin 58 paragrafi (1), pika 1 të Ligjit për sigurimin e obligueshëm, Byroja nacionale për sigurim është e obliguar të formojë Fond garantues që shërben për pagimin e dëmeve të krijuara në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga automjetet motorike të panjohura dhe të pasiguruara dhe rimorkiove, barkave dhe anijeve me motor që janë të pasiguruara si dhe mjeteve fluturuese të pasiguruara.

Në përputhje me nenin 59 paragrafi (1), shoqëritë e sigurimit që kryejnë punë të sigurimit të obligueshëm janë të obliguar të paguajnë mjete në Fondin Garantues që shërbejnë për pagimin e dëmeve në rastet e theksuara në nenin 58 paragrafi (1) të këtij ligji, në shumën proporcionale me preminë e realizuar në klasa të veçanta të sigurimit të obligueshëm në tremujorin paraparak, për tremujorin vijues nga viti në vijim.

Sipas nenit 64 nga i njëjti Ligj, Byroja ka të drejtë në regres në lartësi të dëmit të paguar së bashku me kamatën dhe shpenzimet e pronarit të automjetit të pasiguruar motorik, mjetit fluturues, objektit lundrues dhe pronarit të mjetit transportues në komunikacionin publik gjegjësisht nga personi që e ka shkaktuar dëmin. Pronari, gjegjësisht personi i cili e ka shkaktuar dëmin janë përgjegjës në mënyrë të barabartë ndaj Byrosë.

Nga e ekspozuara, pa kontest rezulton se vetëm Byroja nacionale për sigurim ka të drejtë për regres për pagesën e dëmit për shkak të automjetit motorik të pasiguruar dhe jo shoqëritë për sigurim që kryejnë veprimtari sigurimi të obligueshëm.

Në përputhje me nenin 16 paragrafi (1) të Ligjit për sigurim të obligueshëm, me sigurimin nga përgjegjësia automobilistike përfshihen edhe dëmet e shkaktuara me përdorimin e automjetit nga personi i paautorizuar, kurse sipas paragrafi (3) nga i njëjti nen shoqëria për sigurim që do ta kompensojë dëmin e shkaktuar me përdorimin e automjetit nga personi i paautorizuar, ka të drejtë për regres për shumën e paguar të kompensimit të dëmit, bashkë me kamatën dhe shpenzimet e krijuara në këtë mënyrë nga personi i paautorizuar.

Me ekzistimin e rregullores së qartë ligjore, sipas nenit 64 të Ligjit për sigurim të obligueshëm, për dëmin e krijuar nga automjeti motorik i pasiguruar, të drejtë për regres për shumën e paguar ka Byroja nacionale, kurse sipas nenit 16 të po këtij Ligji, për dëmin e krijuar me përdorimin e automjetit motorik nga personi i paautorizuar, të drejtë për regres për shumën e paguar ka shoqëria për sigurim.